



Pranuar / Dorezuar Prijemeno/Predata Received/Delivered	26. 11. 2020	0	viti god year
Organ /Rjesja Organ /Jednica Org /Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shitjeja Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKANSHICK	2779/2020		113



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Nezavisni Nadzorni Odbor Civilne Službe Kosova
Independent Oversight Board for the Civil Service of Kosovo

A.nr.306/2020

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për shqyrtimin e ankesave i përbërë nga: Eshref Shabani-kryetar, Ardita Haxhinikaj-Demi dhe Jeton Koca-anëtarë, si dhe Hysni Mustafa-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, ka shqyrtuar ankesën A.nr.306/2020 të datës 15.10.2020, të parashtruar nga ankuesi [REDACTED] me adrese Lagjja “Mirdita”, Rr.“Bill Klinton”, p.n, Komuna e Malishevës, kundër organit të punësimit – Komuna e Malishevës, në çështjen juridike “transferim”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim më datën 26.11.2020, mori këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet si e bazuar** ankesa A.nr.306/2020 e datës 15.10.2020, e parashtruar nga ankuesi [REDACTED].
- II. Shfuqizohet** Vendimi Nr.01/1028 i datës 09.10.2020 i Kryetarit të Komunës së Malishevës.
- VI. Obligohet** Kryetari i Komunës së Malishevës që të bëjë zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, duke e kthyer ankuesin në pozitën “Inspektor i Tregut” në Drejtorinë e Inspektoratit, sipas Akt Emërimit Nr.01/212 të datës 25.01.2012.
- V. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës**, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r y e t i m

Ankuesi, [REDACTED], Inspektor i Tregut në Drejtorinë e Inspektoratit në Komunën e Malishevës, me datë 09.10.2020, përmes Aktvendimit Nr.01/1028 të Kryetarit të Komunës së Malishevës, është caktuar në vendin e punës “e-pasuria” pran Drejtorisë për Ekonomi, Financa dhe Buxhet.

I pakënaqur me Aktvendimin Nr.01/1028 të datës 09.10.2020 të Kryetarit të Komunës së Malishevës, ankuesi me datë 15.10.2020 ka parashtruar ankesën me Nr.prot: 2065/2020 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 23.10.2020, ankesën e ankuesit e ka proceduar për përgjigje në ankesë te Komuna e Malishevës. Komuna e Malishevës më datë 04.11.2020 ka përcjell përgjigjen në ankesë me shkresat e bashkangjitura të lëndës (1/5 faqe).

Kolegji për shqyrtimin e ankesave për vendeje në mënyrë meritore ka administruar këto prova: Ankesën me Nr. Prot:2102/2020 të datës 15.10.2020 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Aktvendimin e datës 09.10.2020, me nr.01/1028; Vërtetimin e datës 13.10.2020; Kërkesa për përgjigje e datës 23.10.2020; Përgjigja në kërkesë e datës 04.11.2020; Kërkesa e datës 23.09.2020; Kërkesa e datës 25.09.2020; Akt emërimi nr.01/212 i datës i ankuesit; Dërgesa e postes R-9827635 e datës 03.11.2020.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, për vendosjen e kësaj çështjeje ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët dhe ka konstatuar se ankesa e ankuesit *është e bazuar, sepse:*

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, bazuar në Akt Emërimin nr.01/212 të datës 25.02.2012, ka konstatuar se ankuesi me datë 25.01.2012 ka themeluar marrëdhënien e punës në pozitën Inspektor i Tregut pran Drejtorisë se Inspektoratit në Komunën e Malishevës.

Kryetari i Komunës së Malishevës, në bazë të nenit 38 paragrafi 1 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, me datë 25.09.2020, përmes Aktvendimit Nr.01/1028, ankuesin e ka ri caktuar nga pozita e punës “Inspektor i Tregut” pran Drejtorisë se Inspektoratit, në pozitën e punës “e-pasuria” pran Drejtorisë për Buxhet dhe Financa. Kolegji, bazuar në shkresat e lëndës, ka konstatuar se deri të caktimi ankuesit në pozitën e “e-pasurisë” ka ardhur si rezultat i kërkesës nr.7/173 të datës 25.09.2020 të Drejtorit të Drejtorisë se Inspektoratit, për caktimin e ankuesit në një pozitë tjetër për shkak të pa përgjegjshmërisë dhe sjelljes jo të mirë në komunikim me palët, dhe kërkesës se Drejtorit të Drejtorisë për Buxhet dhe Financa për domosdoshmërinë e plotësimit të pozitës te “e-pasurisë” sipas rekomandimit të Zyrës Kombëtare të Auditimit.

Ankuesi, pretendon se Aktvendimi Nr.01/1028, për caktim e tij në pozitën e punës “e -pasuria” duke u thirr në dispozitat e nenit 38 paragrafi 1 të Ligjit për Zyrtarët Publik, është nxjerr përmes shkeljes se dispozitave procedurale të përcaktuara me Ligjin për Zyrtarët Publik, dhe janë zbatuar gabimisht dispozitat e drejtës materiale.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, lidhur me pretendimin ankimor të ankuesit për shkelje të dispozitave të Ligjit për Zyrtarët Publik, ka konstatuar se mënyra e lëvizjes se nëpunësve civil brenda kategorisë është e përcaktuar me dispozitat e nenit 38 të Ligjit për Zyrtarët Publik. Bazuar në shkresat e lëndës, Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka konstatuar se Komuna e Malishevës me rastin e caktimit të ankuesit në pozitën e “e-pasurisë” nuk ka zhvilluar procedurë konkurruese, andaj Kolegji vlerëson se Aktvendimi Nr.01/1028 i Kryetarit të Komunës se Malishevës është nxjerr në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht nenin 38 paragrafi 1, ku përcaktohet se: *Plotësimi i pozitave të lira në kategorinë profesionale, të ulët dhe të mesme drejtuese, bëhet së pari nga nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, nëpërmjet procedurës së lëvizjes brenda kategorisë, dhe paragrafi 3 ku përcaktohet se: Fillimi i procedurës së konkurrimit shpallet në afat jo më të shkurtër se 15 ditë nga data e caktuar për paraqitjen e aplikimit, në ueb faqen unike të procedurave të konkurrimit të SIMBNJ dhe me mjete të tjera të përshtatshme.*

Kolegji për shqyrtimin e ankesave po ashtu ka konstatuar së arsyetimi i aktvendimit për caktimin e ankuesit në pozitën e e-pasurisë, duke u thirrur në kërkesës nr.7/173 të datës 25.09.2020 të Drejtorit të Drejtorisë se Inspektoratit, për caktimin e ankuesit në një pozitë tjetër për shkak të pa përgjegjshmërisë dhe sjelljes jo të mirë në komunikim me palët, dhe kërkesës se Drejtorit të Drejtorisë për Buxhet dhe

Financa për domosdoshmërinë e plotësimit të pozitës të “e-pasurisë” sipas rekomandimit të Zyrës Kombëtare të Auditimit, është i pa mjaftueshëm dhe kundërthënës, dhe si i tillë nuk i jep mundësi palës që të kuptojë arsyen nëse është caktuar në pozitën e e-pasurisë për shkak të interesit të institucionit apo me qëllim të përmirësimit të rezultateve të punës, andaj Kolegji vlerëson se një arsyetim që është dukshëm i pamjaftueshëm, i paqartë, kundërthënës apo i pakuptueshëm, është i barabartë me mungesën e tij, siç përcaktohet me nenin 47 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative. Kolegji, duke analizuar dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrat e Publikë, po ashtu ka konstatuar se me nenin 34 paragrafi 3, nëpunësit civil i garantohet e drejta e parashtimit të ankesës në KPMSHC për çdo veprim apo mosveprim, që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta këto, që burojnë nga marrëdhënia e Shërbimit Civil, andaj, Kolegji vlerëson se mungesa e informatave për ushtrimin e mjeteve juridike në Aktvendimin Nr.01/1028 të datës 09.10.2020 të Kryetarit të Komunës së Malishevës, bie në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përkatësisht nenin 47 ku përcaktohet se: *1. Akti administrativ i shkruar përmban: 1.4. pjesën përmblyllëse, që tregon kohën e hyrjes në fuqi të aktit, informatat për mjetet juridike, përfshirë organin publik apo gjykatën ku paraqitet mjeti juridik administrativ apo gjyqësor, formën e mjetit, afatin përkatës dhe mënyrën e llogaritjes së tij (këshillën juridike). Në rast kur ushtrimi i ankesës administrative, sipas ligjit, nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ, pjesa përmblyllëse gjithashtu duhet të përmbajë këtë informacion, si dhe bazën ligjore për një përjashtim të tillë.* Si rrjedhojë përmes shkeljeve procedurale, është shkelur edhe ligji material në dem të ankuesit, kështu që Kolegji vlerëson se pretendimet ankimore të ankuesit janë të bazuar.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit nga personi përgjegjës i përcaktuar në dispozitiv të këtij vendimi, Kryetari i Këshillit ndërmerr veprimet në pajtim me nenin 21, 23 dhe 24 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke aplikuar edhe ndalimin e 50 % të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë - Departamenti Administrativ, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda me numër A.nr.306/2020

Hysni Mustafa

Hysni Mustafa
Procesmbajtës

Eshref Shabani

Eshref Shabani
Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet

- Ankuesit, [REDACTED]
- Kryetarit të Komunës së Malishevës;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Malishevës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.